

VENDIM
Nr. 12, datë 10.1.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË M.T.C. ENERGY SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE
TË LUAJTSHME DHE VENDOSJES
SË HIPOTEKËS, PËR ASETET E PALUAJTSHME TË ARDHSHE APO
TË TASHME, NË FAVOR TË RAFFEISEN BANK SHA, PËR EFEKT TË
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË
SË DHËNË**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoria e licencimit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë M.T.C. Energy sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe vendosje të hipotekës mbi asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për efekt të rristrukturimit të kredisë së dhënë,

konstatoi se:

- Me shkresën e datës 22.12.2017, protokolluar në ERE, me nr. 817/2 prot., datë 28.12.2017, shoqëria M.T.C. Energy sh.p.k., ka kërkuar miratimin e ERE-s në lidhje me kërkesën e saj për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, për garantimin e detyrimeve të kredisë.

- Shoqëria M.T.C. Energy sh.p.k. ka marrë dy kredi pranë Raiffeisen Bank sh.a., marrëveshje e nënshkruar në vitin 2012 dhe së fundmi me kontratë, kredi bankare nr. 4087 rep., nr. 2475 kol., datë 7.11.2016, me qëllim për të financuar investimin për ndërtimin e Hidrocentralit Radovë.

- Për garantimin e detyrimeve të kredisë, shoqëria ka vendosur si garanci në favor të Raiffeisen Bank sh.a., asetet e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë sipas kontratave dhe i drejtohet ERE-s me kërkesën për miratimin e lënies peng të aseteve të luajtshme dhe vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme, për garantimin e detyrimeve të kredisë.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 7, pika 1, germa “j” (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt).

- Nenin 7, pika 3 (subjektet koncencionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen, për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi), do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 10, pika 2 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë M.T.C. Energy sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të vendosjes së hipotekës për asetet e paluajtshme të ardhshme apo të tashme,

të shoqërisë në favor të Raffeyen Bank sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti